

FJALA E DEPUTETIT EDUARD SHALSI

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë, Të gjithë e dimë që Banka e Shqipërisë është një ndër institucionet më të rëndësishme për jetën ekonomike dhe financiare të vendit dhe me një sërë detyrash, përgjegjësish dhe funksionesh me rëndësi domethënëse për ekonominë e vendit dhe për mirëqenien e shoqërisë. Nuk dua të hyj në përgjegjësitë e Bankës së Shqipërisë, por e gjej me vend që në krye të herës të shpreh mbështetjen time, të komisionit dhe të deputetëve për propozimin e kandidaturës së zotit Gent Sejko, si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Në gjykimin tonë është një propozim që nuk vjen në mënyrë të rastësishme, pasi gjatë 7 vjetëve të kaluara Gent Sejko ka ushtruar jo thjesht detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, por edhe atë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Ka një eksperiencë të gjatë profesionale në sektorin publik dhe në sektorin privat. Mjafton t'ju them se (e kam për deputetët e rinj, pasi të vjetrit e njohin mirë) ka qenë drejtues në Departamentin e Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, auditor i lartë dhe konsulent pranë firmës Deloitte&Touche, drejtor i Divizionit të Auditimit të Brendshëm, Përputhshmërisë dhe Marrëdhënieve me Qeverinë, drejtor i Korporatave pranë bankës "Raiffeisen", zëvendës drejtor i Përgjithshëm dhe drejtor i Divizionit Retail pranë bankës Societe Generale, si dhe drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Leasing.

Është zgjedhur si Guvernator i Bankës së Shqipërisë në datën 8 shkurt 2015, ndërkohë që më 22 dhjetor të vitit të kaluar Këshilli Mbikëqyrës ka votuar unanimitet për t'i propozuar Kuvendit të Shqipërisë, zotin Gent Sejko si anëtar të këtij Këshilli. Duhet theksuar se mandati i tij si Guvernator ka përkuar me disa sfida të rëndësishme për ekonominë shqiptare, sidomos për sektorin e saj financiar, por, gjithashtu, edhe për institucionin e Bankës së Shqipërisë, pasi duhet theksuar që është një ndër institucionet që gëzon besimin më të lartë të publikut shqiptar. Në krye të këtij institucioni ka demonstruar një vizion strategjik dhe aftësi do të thosha të veçanta për të përballuar sfidat e kohës, por edhe për të vendosur disa piketa të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. Janë një numër i konsiderueshëm arritjesh të Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe, por do të doja të veçoja, pa ju marrë shumë kohë, disa prej tyre: Ka bërë një progres të dukshëm në sistemin e pagesave; ka qenë një kontributor i rëndësishëm i zhvillimit të tregjeve financiare; ka qenë edhe një aktor i rëndësishëm në proceset e integritetit europian. Dukshëm, komunikimet me publikun, që kanë zgjuar gjithmonë interes dhe kanë shtuar akoma edhe më shumë besimin, kanë qenë gjithmonë cilësore. Në sferën e diskutimit ekonomik Banka e Shqipërisë, nën drejtimin e Gent Sejkos, ka ditur të ketë një prezencë autoritare gjithmonë në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së të gjitha atyre detyrave, funksioneve dhe përgjegjësi që ka.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të rifreskimit të një pjese të kartëmonedhave shqiptare, duke parë tashmë që janë në përputhje edhe me standardet më të mira të fushës. Ndaj, dua të theksoj që ne në komision unanimitet e kemi mbështetur kandidaturën e Gent Sejkos dhe do t'i ftoja të gjithë anëtarët e nderuar të parlamentit ta mbështesim, duke theksuar edhe një element shumë të rëndësishëm të karakterit të tij. Në një kohë kur shpeshherë institucione, të cilat duhet të jenë mbi palët, duhet të

jenë të pavarura, ne i kemi parë të pozicionohen politikisht, të mos jenë të pavarura, të jenë të njëanshme, ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka ruajtur nën drejtimin e Gent Sejkos një rol të qenësishëm, që ka ndihmuar shumë edhe në përballimin e dy sfidave të mëdha, me të cilat u ndesh qeveria dhe të gjithë ne si shoqëri: tërmeti dhe pandemia. Dua t'i ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta mbështesim kandidaturën e Gent Sejkos si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës në këtë fazë. Faleminderit!